



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 17205 Prot.

Vlorë, më 22.10. 2025

PROJEKTVENDIM

**“PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA AFATIT TË MANDATIT, TË
KËSHILLTARES EVIS QËNDRO ALLUSHI”**

Bazuar në Ligjin Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 49, pika 2, pika 4/a dhe b, si dhe pika 5, në Rregulloren “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë”, Neni 21, pika 1/b dhe “c”, pika 7 dhe 13, si dhe në shkresën datë 09.10.2025, e protokolluar në Bashki me Nr 16344 Prot, të zonjës Evis Allushi, nëpërmjet së cilës, ka paraqitur dorëheqjen nga funksioni i anëtares së Këshillit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës 30.10.2025,

VENDOSI:

1. Të deklarojë mbarimin para afatit të mandatit të këshilltares Evis Qëndro Allushi, për shkak të emërimit të saj, si Prefekte e Qarkut Vlorë.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri



Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË**

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR DEKLARIMIN E MBARIMIT PARA AFATIT TË
MANDATIT, TË KËSHILLTARES EVIS QËNDRO ALLUSHI”**

Para Këshillit të Bashkisë!

Të nderuar Këshilltarë!

Projektvendimi “Për deklarimin e mbarimit para afatit të mandatit të këshilltares Evis Qëndro Allushi”, është paraqitur në kuadër të procedurave të parashikuara në Ligjin Nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 49, për raste të tilla,

Konkretisht, sikurse jeni vënë dijeni , zonja Evis Allushi, është emëruar në detyrën e Prefektit të Qarkut Vlorë dhe, bazuar në Ligjin Nr 107/2016, datë 27.06.2016 “Për Prefektin “, i ndyshuar , Neni 7, pika 2, nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe anëtare e Këshillit të Bashkisë.

Në këto kushte , me shkresën datë 09.10.2025, ka paraqitur pranë Sekretariatit për Këshillin e Bashkisë , dorëheqjen si anëtare e Këshillit të Bashkisë .

Për rrjedhojë , jemi në kushtet e përfundimit para afatit të mandatit të këshilltarit, që sipas Nenit 49 pika 5 të Ligjit Nr 139/2015, deklarohet me Vendim të Këshillit të Bashkisë.

Nga sa më lartë, duhet të miratojmë deklarimin e mbarimit të mandatit, për të vijuar procedurat përkatëse me KQZ, lidhur me këshilltarin që është nga lista e Partisë Socialiste, në radhë për ta zëvendësuar.

Duke ju falënderuar.

KRYETAR

Elpiniq Mërkuri





16344
09.10.2025.

REPUBLIKA SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ Prot _____

Vlorë, më 9 . 10 . 2025

Lënda: Njoftim për dorëheqjen nga mandati i anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

KËSHILLIT TË BASHKISË
ZNJ. ELPINIQI MËRKURI,
Kryetare e Këshillit të Bashkisë

Për arsye se, me Vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, jam emëruar me detyrën e Prefektit të Qarkut Vlorë, bazuar në Ligjin Nr. 107/2026, datë 27.06.2016, "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, Neni 7, pika 2, si dhe në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Neni 49, pika 4/b, ju njoftoj dorëheqjen nga funksioni i anëtarit të Këshillit të Bashkisë Vlorë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, shpreh besimin tim se edhe në të ardhmen Këshilli i Bashkisë Vlorë do të vazhdojë të ushtrojë funksionet e tij në dobi të qytetit tonë.

ANËTARE E KËSHILLIT TË BASHKISË

Evis Allushi